

VENDIM
Nr. 47, datë 7.11.2017

PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË SHËRBIMIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA PËR SHOQËRINË UJËSJELLËS-KANALIZIME TIRANË SHA

Në mbështetje të nenit 14 dhe 21, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", të ndryshuar, vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 39, datë 9.12.2015, "Për miratimin e politikës tarifore për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 40, datë 9.12.2015, "Për miratimin e dokumen-tacionit mbështetës për miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimin e ujërave të ndotura", vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 41, datë 9.12.2015, "Për miratimin e procesit të miratimit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimin e ujërave të ndotura", dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 42, datë 9.12.2015, "Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimin e ujërave të ndotura", Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Miratimin e tarifave për shoqërinë Ujësjiellës-Kanalizime Tiranë sh.a., si më poshtë:

a) Tarifë volumetrike për shërbimet:

Kategoria e klientëve	Furnizim me ujë	Largimi i ujërave të ndotura
Klientë familjarë	65 lekë/m ³	11 lekë/m ³
Klientë publikë	140 lekë/m ³	30 lekë/m ³
Klientë privatë	155 lekë/m ³	35 lekë/m ³
Klientë të veçantë (Prodhim pije alkoolike, freskuese, pishina)	170 lekë/m ³	40 lekë/m ³
Furra buke	95 lekë/m ³	13 lekë/m ³
Shitje uji me shumicë	12 lekë/m ³	-
HEC Lanabregas	5 lekë/m ³	-

b) Tarifë fikse

Klientë familjarë	200 lekë/muaj/klient
Klientë publikë	200 lekë/muaj/klient
Klientë privatë	200 lekë/muaj/klient
Klientë të veçantë (Prodhim pijesh alkoolike, freskuese, pishina)	200 lekë/muaj/klient
Furra buke	200 lekë/muaj/klient

2. Objektivat e Treguesve Kryesorë të Performancës për vitin 2018, 2019 dhe në fund të vitit të 5-të (2022) janë sipas planit të biznesit si më poshtë:

Treguesit e performancës	Viti 2018	Viti 2019	Pritshmëria/viti 2022
Uji pa të ardhura (humbjet)	65%	60%	40%
Niveli i matjes	77%	78%	97%
Kohëzgjatja e furnizimit			24 orë/ditë
Eficienca e stafit			2.45 punonjës/000/lidhje
Mbulimi me ujë	90%	93.5%	95.3%
Mbulimi me kanalizime	78.7%	80.1%	83.5%
Norma e arkëtimit	90%	91%	92%
Cilësia e ujit (klor+koliform)	Sipas standardeve	Sipas standardeve	Sipas standardeve

3. Pagesa rregullatore vjetore për shoqërinë Ujësjellës-Kanalizime Tiranë sh.a. do të jetë 0.6% e të ardhurave vjetore të parashikuara nga aktiviteti.

4. Vendimi i Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 40, datë 22.12.2011, “Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik për sh.a. UK Tiranë”, shfuqizohet.

5. Ky vendim hyn në fuqi më 1.1.2018 dhe është i vlefshëm deri në miratimin e tarifave të reja.

KRYETARI
Ndriçim Shani